

[Shpalljet ▼](#)[Kthehu](#)

#01033

**INSTITUTI I STATISTIKAVE****Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë  
punonjës me kontratë pune në pozicionet:  
SPECIALIST GIS****TITULLI I SHPALLJES "SPECIALIST GIS" NE KUADER TË CENSIT TE  
POPULLSISË DHE BANESAVE****Termet e referencës:**

Detyrat Kryesore:

- Të përdorë sistemet e informacionit gjeografik (GIS) për të krijuar dhe mirëmbajtur të dhëna gjeografike dhe/ose harta të harmonizuara nga një shumëllojshmëri burimesh, duke përfshirë census-et, përditësimet në terren, imazhet satelitore, fotografi ajrore, dhe harta ekzistuese, të cilat mund të kombinohen me të dhëna statistikore social ekonomike, demografike etj.
- Të japë suport teknik për sektorin në implementimin dhe monitorimin e operacioneve të ndryshme në kuadër të projekteve GIS;
- Të instalojë dhe testojë e aplikacionet GIS (pajisjet e mbledhjes së të dhënave në terren) dhe t'i mirëmbajë ato;
- Të japë udhëzime teknike për përdoruesit e aplikacioneve GIS (anketuesve të terrenit dhe operatorëve të zyrës);
- Të ndihmojë sektorin në përmirësimin e aplikacionit GIS dhe punës në përgjithësi në kuadër të përgatitjeve për Cens;
- Të jetë në kontakt të vazhdueshëm me zhvillimet më të fundit në fushën e GIS në funksion të përmirësimit të punës;
- Të kryejë trajnime në lidhje me aplikacionet GIS nëse do t'i kërkohej;
- Të dalë në terren për kontrolle apo monitorime të punës së anketuesve të terrenit në kuadër të anketës së përditësimit të hartave;
- Të kontrollojë dhe monitorojë punën e operatorëve GIS në kuadër të anketës së përditësimit të hartave;
- Të përgatisë dhe printojë harta të anketave të ndryshme që zhvillon INSTAT-i si

dhe të kryejë trajnime të ndryshme nëse do t'i kërkohet;

- Të zbatojë ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe standardet / rekomandimet ndërkombëtare, Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ) dhe në Planin Vjetor të Punës të Institutit të Statistikave në funksion të prodhimit të gjeostatistikave të harmonizuara, asnjënjë, transparente dhe të përditësuara.
- Kryen detyra të tjera që mund t'i ngarkohen.

### **Kriteret e përzgjedhjes:**

Arsimi:

Master Shkencor në fushën e Gjeografisë, Inxhinieri Gjeologji, Gjeoinformatikë, Informatikë dhe fusha të tjera të ngjashme me profilin e punës.

Njohuri:

- Të ketë njohuri në fushën e GIS;
- Eksperienca të mëparëshme në fushën e GIS përbën avantazh;
- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programit ArcGIS, Autocad;
- Të ketë aftësi të mira analitike, të komunikimit verbal dhe me shkrim, aftësi të mira ndërpersonale dhe aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur apo si pjesë e një grupi.
- Të ketë njohuri të mira në gjuhën angleze

### **Informacione të tjera:**

Kushtet e punës:

Specialistit mund t'i lindë nevoja të punojë jashtë orarit zyrtar, ose të jetë i gatshëm të punojë me dy turne nëse do t'i kërkohet, në varësi të ngarkesës së punës që mund të ketë, kryesisht gjatë aktiviteteve voluminoze (cens, vrojtime në shkallë të gjerë, etj).

Periudha e kontraktimit do të jete deri ne daten 31.12.2022.

Aplikantet do të nënshtrohet një proçesi testimi / intervistimi

### **Afati i aplikimit:2/28/2022**

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqest së Institutit të Statistikave në seksionin e vendeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.